Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

***Ilaz Papaj**-Ekspert Shqyrtues*	*Data e autorizimit të ekspertit 30.03.2022*	*Data e dorëzimit të raportit 08.04.2022*	*Nr. i lëndës:* *71/22*

BAZA LIGJORE E SHQYRTIMIT

Me datën: 23.03.2022, OE"KosovaMed Healthcare" Shpk - Prishtinë,ka parashtruar ankesë me nr: 71/22, kundër njoftimit për kontratë,lidhur me aktivitetin e prokurimit "Ofrimi i shërbimeve shëndetësore, sociale, arsimore, ambientale dhe administratë e përgjithëshme", me nr.të prokurimit: 612-22-484-2-1-1,iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –"KK Fushë Kosovë".
Autoriteti kontraktues ka zbatuar **procedurë të hapur**,lloji i kontratës:**Kontratë Publike Kornizë, Shërbime,**vlera e parashikuar e kontratës:**1,402,750.00 €.**

Konform nenit 113, 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, Eksperti Shqyrtues i ka shqyrtuar pretendimet ankimore të OE ankues.

DISPOZITAT E SHKELURA DHE PRETENDIMET ANKIMORE

(Të përshkruhendispozitat e shkelura dhe vetëm pikat e ankesës).

Ankuesi paraqet Ankese kundër dokumenteve te tenderit dhe njoftimit për kontrate ne pajtim me Nenin 108/A Paragrafi 3"Kërkesa për shqyrtim duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues, me postë ose me çdo mjet tjetër të komunikimit të lejuar me këtë ligj, brenda afateve të mëposhtme" Pika 1 "në qoftë se shkelja e supozuar ka të bëjë me njoftimin e kontratës ose me dokumentet e tenderit brenda pesë (5) ditëve para afatit të fundit për dorëzim të ofertave".

KERKESE PËR RISHQYRTIM 10.03.2022 OE ankues me date:10.03.2022 kemi paraqit kërkese për rishqyrtim kundër njoftimit për kontrate dhe dokumenteve te tenderit me pretendimet ankimore se dosja e tenderit nuk është ne pajtim me LPP-ne.

REFUZIMI I KERKESES 14.03.2022 Përmes e-prokurimit me date 14.03.2022 kemi pranuar vendimin nga ZPP për refuzimin te kërkesës për rishqyrtim si te pabazuar.
Dëshmitë: Te bashkangjitura

Pretendimet ankimore ne kërkesën për rishqyrtim dhe ankese janë si vijon:
KUVENDI KOMUNAL FUSHË KOSOVË
Titulli: Ofrimi i shërbimeve shëndetësore, sociale, arsimore, ambientale dhe administratë e përgjithëshme
Nr. i **Prokurimit: 612-22-484-2-1-1**
Nr i **brendshëm: 612 22 001 211**

Njoftimi per kontrat e ketije tenderi eshte ber me daten **03.02.2022** ne platformen Elektronike e-prokurimi ndersa data e hapjes se ketije tenderi eshte planifikuar me daten 16.03.2022 ndersa vlera e planifikuar eshte 1.402.750,00 euro per 24 muaj.
PROV 1: Njoftimi per kontrate

Tenderi eshte parapergaditur qe ne fillim dhe eshte i kurdisur per nje apo dy OJQ te parapercaktuar sepse ka kerkesa diskriminuese dhe ne menyre automatike nuk mund te marrin pjese per shkak te ketyre kerkesave diskriminuese.
E qe eshte ne kundershtim me Nenin 1, Nenin 7, Nenin 27, Nenin 28

Pretendimi ankimor Nr.1

Dosja e tenderit eshte pa sqarime substanciale qe ne kushte normale nuk mundet askush kete projekt ta realizoi. Nuk eshte dhene asnje specifik teknike per punet qe do te kryhen perveq paramases ne xl qe eshte e pergjithshme.

Nese qeillimi i kontrates eshte ofrimi i sherbimeve shendetsore mbrenda QKMF dhe AMF ku eshte dashte te caktoni sa infermier do te jene ne QKMF dhe sa ne AMF, gjithashtu Edhe ne teren sa infermier do te jene edhe ne sherbime shtepiake.

Eshte dashur te percaktoni numrin e ekipeve mjekesore ne teren sa ekipe do te jene, konkret nese ne teren do te jene dy ekipe ateher ju nevoiten dy automjete apo jo, Sherbime arsimore, sociale, ambientale dhe administrate e pergjithshme duhet te percaktohen qarte, ku do te mbahen sherbimet, sa pjesemarres do te ken, sa her ne jave dhe sa pjesemarres do te marrin pjes ne keto seanca sociale, arsimore, ambientale apo ne administrate te pergjithshme dhe per cfare qellimi.

Per kryerjen e sherbimeve shendetsore nuk eshte bere nje paramas dhe nje plan konkret. Ne asnjevend ne dosjen e tenderit nuk e keni percaktuar sa do te jete koha e punes, dmth sa ore ne dite ne jave dhe nuk keni percaktuar sasia e te ardhurave sa do te jete, per mjekun, motren medicionale apo infermieret.Shpenzimet e derivative, ekipet e terenit duhet te jene ne gatishmeri 24 ore qe do te thote edhe gjate vikendit apo vetem diteve te punes.

Pretendimi ankimor Nr.2

Gjithashtu Kerkesat e pershatmerise profesionale:

III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:

3.Operatori Ekonomik duhet te jetë i licencuar nga Institucionet vendore(Ministria e Shëndetesis) per ofrimin e sherbimeve te kerkuara.

4.Operatori Ekonomik duhet te posedoje certifikate licencimi (MFPT) per ofrimin e sherbimeve sociale dhe familjare.

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1.Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqme AK-se se qarkullimi i OE ne tri vitet e fundit eshte jo me pak se 2 805 500 euro

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:

1.Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në tri (3) vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit per kontratë në vlere prej min. 2 104 125 €. Ne rast te grupit lideri duhet ti kete se paku 60 % te shumes se kerkuar shërbime te natyres se ngjajshme.

Pika 2.2 Pershtatshmeria profesionale nen 3 dhe 4 kerkesa jane kerkesa diskriminuese qe mundet vetem nje apo dy OJQ ti plotesojne dhe asnje OE nuk ka mundesi ti ploteson keto kerkesa

Faktikisht me kerkesen ne 3 dhe nr. 4 ju keni para-percaktuar fituesin e ketije tenderi. Keto kerkesa leshohen nga autoritetet perkatese vetem per OJQ qe operojne per qellime te sherbimeve jo-fitimprurese ne komunitete te ndryshme. Fatkeqesisht nje shume e konsiderueshme e fondeve publike duke keqperdorur buxhetin e Republikes se Kosoves po shkon ne dem per shoqerin tone nje projek i tille si ky qe ne start te jete i deshtuar.

Pretendimi ankimor Nr.3

Pika 2.3 Kapaciteti ekonomik dhe financiar dhe 2.4 Pershtatshmeria profesionale eshte kerkuar ne menyre tendencjoze ne menyre qe te pamundesohet pjesemarrja OE te interesuar ne kete procedure te prokurimit dhe te mbahet monopoli vetem nga nje OJQ apo OE. Ne menyre qe te lejohet pjesemarrja per OE tjere duhet te lejohet 50% apo 60% e vleres se tenderit.

Sa i perket Pikes 2.2 dhe 2.3 pas hulumtimeve te bera nga ana jone ne KRPP dhe ne web faqen e OSHP-se kemi hasur ne **Vendimin e OSHP-se te dates 24.06.2020 PSH. Nr. 305/20** ku ne kete vendim eshte cilesuar si ngushtim i konkurrences duke kerkuar dokumentet e larteshenuara per referenca me volum kaq te madh duke i dhene perparesi monopolit, si dhe te pika tjeter e Licences se OE apo OJQ, ne vend te kesaj mund te kerkohet licenca e punetorit shendetesor qe do te ofroj direkt sherbime shendetesore ne njerez.

PROV 2: Bashkangjitur Vendimi PSH. Nr. 305/20

E qe eshte ne kundershtim me Nenin 1, Nenin 7, Nenin 27, Nenin 28 dhe Neni 69

Mundesisht te hiqen keto kerkesa diskriminuese dhe ne vend te tyre te kerkohen Licencat per infermieret dhe motrat, gjithashtu edhe vertetimi apo liqenca profesionale mbi pervojen e punes.

Neni 1 - **Qellimi**
Neni 7 - **Barazia ne Trajtim/ Jo- Diskriminimi**
Neni 27 - **Dosja e Tenderit**
Neni 28 - **Specifikimet teknike**
Neni 69 - **Neni 69 Paragrafi 4 Pika (ii) Aftësia Teknike dhe/ose Profesionale**

PROV 3: Kerkese per ri-shqyrtim
PROV 4: Vendimi i kontrates per rishqyrtim nga AK
PROV 5: B52 Permiresim i gabimit

Ne kerkojme **qe te APROVOHET Ankesa jone si e bazuar dhe te MODIFIKOHET Dosja e tenderit dhe te mundesohet trajtim i barabarte qe te aplikojme ne kete procedure te prokurimit ne baze te kerkesave dhe deshmive ne FDT per sherbime shendetesore dhe ti** eleminoj kriteret te cilat nuk jane ne perputhje me LPP-ne qe tenderi te jete i hapur dhe jo i dedikuar per nje apo dy OJQ si ne rastin konkret, në mënyre që të mos keqpërdoret buxheti i Republikës së Kosovës dhe te Percaktoj qarte kerkesat e AK numrin e infermiereve, numrin e stafit Teknik mjekesore OE qe merr kontraten para nenshkrimit te kontrates te kete kontratat e te gjithe stafit te vertetuara dhe te percaktohet ne kontrate shuma e te ardhurave personale sa do te jete per mjekun dhe stafin tjeter mjekesore, gjithashtu pushimi dhe tjerat sipas Ligjit te Punes ne Fuqi.

KRITERET PËR VLERËSIM

-Dosja e tenderit

Përshtatshmëria profesionale:
Kërkesa 3.Operatori Ekonomik duhet te jetë i licencuar nga Institucionet vendore(Ministria e Shëndetesis) per ofrimin e sherbimeve te kerkuara
Dëshmia : 3. Dëshmui - Licenca per ofrimin e sherbimeve te Specialistike te Mjeksesis Familjare
Kërkesa . 4.Operatori Ekonomik duhet te posedoje certifikate licencimi (MFPT) per ofrimin e sherbimeve sociale dhe familjare
Dëshmia 4. Certifikat licencimi per ofrimin e sherbimeve sociale dhe familjare per persona te moshuar,persona me aftesi te kufizuara dhe femij te margjinalizuar ne nivel nacional

Kapaciteti ekonomik dhe financiar:
Kërkesa: 1.Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi të kënaqme AK-se se qarkullimi i OE ne tri vitet e fundit eshte jo me pak se 2 805 500 euro.
Dëshmia 1-Delarata nga banka për qarkullimin e OE ose pasqyrat e audituara financiare ose deklaratat vjetore tatimore te dorezuara ne ATK.

Kapaciteti teknik dhe professional
Kërkesa:1.Operatori Ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në tri (3) vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit per kontratë në vlere prej min. 2 104 125 €. Ne rast te grupit lideri duhet ti kete se paku 60 % te shumes se kerkuar shërbime te natyres se ngjajshme.
Dëshmia:1. Një listë të kontratave të realizuar ne tri vitet e fundit duke saktsuar produktet e perfshira, shumen e kontrates, daten dhe pranuesit te percjella me referenca perkatese ose proceset e pranimeve për projektet e përfunduara – kopje.

RAPORTI I KOMISIONIT RIVLERËSUES

///

INFORMACIONET SHTESË TË MARRA ME ANË TË SQARIMEVE TË KERKUARA NGA E EKSPERTËVE SHQYRTUES DHE / OSE TEKNIK

///

VLERËSIMI SIPAS NENIT 4.1.26 TË LPP-së

(Të jepet një vlerësim se OE ankues është apo nuk është palë me interes sipas nenit 4.1.26).

///

VENDIMET E MËPARSHMETË PSH-së LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

(Të sqarohet nëse për rastin e njejtë është dhënë vlerësim tjetër).

///

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

(Të sqarohet për rastin se pse është devijuar nga praktika e mëparshme).

///

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE ANKUES "KOSOVAMED HEALTHCARE" SHPK - PRISHTINË

Përgjigje në Pretendimin 1.

Lidhur me pretendimin e OE ankues "KosovaMed Healthcare" Shpk, se AK gjatë pregaditjes së dosjes së tenderit/njoftimit për kontratë nuk ka dhënë sqarime substanciale për punët që do të kryhen,duke mos specifikuar sa infermier duhet të jenë në QKMF,sa duhet të jenë në terren,sa duhet të jetë numri i ekipeve mjekësore apo edhe specifika tjera por vetëm është paraqitur një paramase që sipas OE ankues nga AK nuk janë ofruar informata të mjaftueshme dhe është e pamundshme te realizohet ky projekt pa keto informata,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Eksperti shqyrtues sqaron se AK në dosje të tenderit ka përcaktuar disa specifika përgjithësuese dhe paramasën tek tabela e çmimeve qe janë të përgjithësuara.
AK gjatë pregaditjes së Dosjes së tenderit duhet të ketë kujdes që të përcaktoj specifika sa më të qarta dhe të plota.AK është dashur të specifikoj për aq sa është e mundur numrin e ekipeve mjekësore në QKMF apo në terren,stafin tjetër që do të merrë pjesë në këtë projekt dhe të përcaktoj qartë se në cilat pika do të bëhët shërbimi 24 orë, ku do të punohet gjatë vikendeve etj.Përgjigjia e AK-së në kërkesën për rishqyrtim se të ardhurat personale,koha e punës e të ngjashme do të rregullohen ashtu siq e parasheh Ligji i Punës,për ekspertin shqyrtues është jo i mjaftueshëm sepse Ligji i Punës nuk i përcakton të ardhurat personale.Ligji i Punës përfshin shume detyrime që lidhen me të drejtat e punëtorëve sic janë orari i punës, pagesa e ndrrimeve të natës,pagesa e diteve të vikendeve dhe festave,pushimeve vjetore dhe shume detyrime tjera të cilat duhet të specifikohen në dosje të tenderit. Eksperti shqyrtues sqaron se AK duhet të plotësoj dosjen e tenderit me informata të plota për zbatimin e çdo pjese të projektit me qëllim që OE e interesuar të kenë informata të plota për pregaditjen e ofertës së tyre financiare e cila do të ishte me reale/konkurruese dhe e cila do të jetë edhe në dobi të vet buxhetit të AK-së dhe në zbatim të nenit 1 dhe 6 të LPP-së.

Konsideroj që pretendimi ankimor është pjesërisht i bazuar

Përgjigje në Pretendimin 2.

Sa i përket pretendimit tjetër të OE ankues se tek kërkesa e përshtshmërisë profesionale është kërkuar që OE duhet të jetë i licencuar nga institucionet vendore (Ministria e Shëndetësise) dhe të posedoj çertifikatë licencimi (MFPT) për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare që sipas OE ankues janë kërkesa diskriminuese,eksperti shqyrtues ka këtë mendim.

Në dosje të tenderit tek kërkesa 3 e përshtshmërisë profesionale është kërkuar që OE duhet të jetë i licencuar nga Institucionet vendore (Ministria e Shëndetesis) për ofrimin e shërbimeve të kërkuara e dëshmuar me licencën për ofrimin e shërbimeve Specialistike të Mjeksisë Familjare,gjithashtu në pikën 4 është kërkuar që Operatori Ekonomik duhet të posedoje çertifikatë licencimi (MFPT) për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare e dëshmuar me çertifikat licencimi për ofrimin e shërbimeve sociale dhe familjare për persona të moshuar,persona me aftësi të kufizuara dhe fëmij të margjinalizuar në nivel nacional.

Eksperti shqyrtues sqaron se ky aktivitet i prokurimit është projekt specifik që hyn të procedurat me vlerë të madhe (1,402,750.00 €) dhë është në kompetencë të AK të përcakoj kritere/kërkesa që sigurojnë ekzekutimin e projektit në mënyre sa më efikase.Për të dy kërkesat e lartëcekura,liçencat lëshohen nga institucionet vendore dhe për ekspertin shqyrtues është i pa qartë pretendimi i OE ankues për kërkesa diskriminuese,andaj ky pretendim është i pa bazuar

Përgjigje në Pretendimin 3.

Lidhur me pretendimin e OE ankues ”KosovaMed Healthcare” Shpk se AK tek kërkesa 2.3 e kapacitetit ekonomik dhe financiar dhe kërkesa 2.4 e kapacitetit teknik dhe profesional ka përcaktuar shuma në mënyre tendencioze që të pamundsohet pjesëmarrja e OE të inetersuar dhe të ruhet monopoli nga nje OJQ apo OE që sipas OE ankues janë kërkesa në kundërshtim edhe me vendimin e Panelit Shqyrtues PSH.nr,305/20 ,eksperti shqyrtues ka këtë mendim

Në dosje të tenderit tek kërkesa kapacitetit ekonomik dhe financiar është kërkuar që OE duhet të ofroj dëshmi të kënaqme AK-së se qarkullimi i OE në tri vitet e fundit është jo me pak se 2,805, 500 euro,ndërsa tek kërkesa e kapacitetit teknik dhe profesional është kërkuar që OE duhet të ofroj dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së ngjajshme në tri (3) vitet e fundit nga data e publikimit te njoftimit për kontratë në vlere prej min. 2,104,125.00 €. Në rast të grupit lideri duhet ti kete se paku 60 % te shumës se kërkuar shërbime të natyres se ngjajshme.

Eksperti shqyrtues sqaron se për të dy kërkesat e përcaktuara në dosje të tenderit lidhur me kapacitetin ekonomik dhe financiar dhe kapacitetin teknik dhe profesional,AK ka përcaktuar kërkesa konform nenit 68 dhe 69 të LPP-së dhe RRUOPP-së dhe pretendimi i OE ankues se këto kërkesa mundësojnë monopolin për një OJQ apo OE është i pa bazuar.
Eksperti shqyrtues sqaron se kjo procedurë e prokurimit është procedurë me vlerë të madhe dhe për OE të cilët nuk kanë kapacitetet e majftueshme apo OE qe janë futur rishtas në treg Ligji i i Prokurimit mundëson ofertimin përmes grupit të OE.

Pretendimi ankimor është i pa bazuar

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të **aprovohet pjesërisht si e bazuar** dhe rekomandon autoritetin kontraktues që ta **PLOTËSOJ** Dosjen e Tenderit.

Raporti i eksperizës ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues – KK FUSHË KOSOVË
- Panelit Shqyrtues – OSHP
- OE ankues – “KOSOVAMED HEALTHCARE” SHPK